

Bashkëpunimi Gjatë Pandemisë: i Vërtetë apo i Pretenduar

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) mbledhi një grup ekspertësh nga Serbia dhe Kosova për të dytën herë që nga fillimi i pandemisë për të diskutuar, përmes një teleconference, zhvillimet në marrëdhëniet midis Beogradit dhe Prishtinës gjatë kësaj krize globale. Shumë pjesëmarrës u shprehën se janë të kënaqur me bashkëpunimin midis ministrave të shëndetësisë të Serbisë dhe Kosovës. Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë gjithashtu morën disa hapa inkurajues, por jo aq të pëlqyer nga publiku: Prishtina i lejoi disa mjekë dhe punëtorë shëndetësor nga Serbia të shërbenin në komunat me shumicë serbe të Kosovës; komunat me shumicë serbe në veriun e Kosovës respektuan masat e Kosovës; Serbia dhuroi 1000 teste COVID-19 për Kosovën dhe Prishtina i pranoi ato, megjithëse pati kritika të ashpra nga partitë e opozitës në Kosovë; Prishtina i dhuroi 500,000 euro Luginës së Preshevës dhe Beogradi lejoi që këto fonde të kalonin; Ministrat e shëndetësisë dhe të jashtëm të Serbisë dhe të Kosovës morën pjesë në diskutime të ndryshme rajonale përmes telekonferencave. Së fundi, por jo më pak me rëndësi, nuk pati as edhe një incident të vetëm ndërtnik që nga fillimi i pandemisë. Komuniteti ndërkombëtar, kryesisht disa vende të BE-së, e përkrahën dhe në disa raste e lehtësuan një bashkëpunim të tillë.

Gjatë punëtoris u shqyrtua ky bashkëpunim dhe u ofruan rekomandime se si marrëdhëniet mes Serbisë dhe Kosovës të bazohen në këto zhvillime pozitive, për të përmirësuar dhe zgjeruar bashkëpunimin edhe në fusha të tjera gjatë dhe pas kësaj pandemie. Pjesëmarrësit gjithashtu shqyrtuan përgjigje të mundshme për pyetjet për të luftuar presionet populiste kundër çdo bashkëpunimi dhe ruajtjen e një toni konstruktiv të komunikimit në të ardhmen. Ata gjithashtu bënë disa parashikime për marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë gjatë asaj që pritet të jetë një verë "e nxehtë" në Beograd dhe Prishtinë, dhe ndoshta në Bruksel dhe Washington.

Punëtorja është pjesë e një iniciative më të madhe të CIG për marrëdhëniet Kosovë-Serbi e mbështetur dhe zbatuar në bashkëpunim me Departamentin Federal të Zvicrës për Punë të Jashtme.

Virusi COVID-19 ka treguar se kur ka përballje me një kërcënim të përbashkët, ekziston një interes i përbashkët për të bashkëpunuar. Dhurimi i 1000 testeve nga Beogradi dhe pranimi i Prishtinës tregojnë se ekziston një vullnet për bashkëpunim nga të dy palët, edhe kur hapa të tillë janë jopopullorë dhe ndonjëherë politikisht të dëmshëm. Lejimi i punonjësve mjekësorë serbë që të punojnë në Kosovë, dhe fakti që veriu pranoi dhe respektoi masat e përcaktuara nga Prishtina gjatë pandemisë tregojnë se të dy palët mund të shohin domosdoshmërinë e bashkëpunimit dhe se nuk ia vlen që palët të vazhdojnë të insistojnë në parimet e vjetra në momentet kur situata del jashtë të kontrollit.

Edhe pse pati rezultate pozitive të bashkëpunimit në luftën kundër COVID-19, efektet reale disa here kanë munguar. Në Serbi, informacioni u injorua kryesisht nga shumica e mediave

kombëtare, ndoshta për shkak të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Në Kosovë, ky bashkëpunim mori pak mbështetje. Përkundrazi, shumë e kritikuan dhe thanë se ishte kundërproduktiv, duke thënë që dhurimi ishte si një lloj "Kali i Trojës" për Kosovën ose "poshtërim". Disa madje thanë që testet kishin origjinë nga Rusia ose Kina, kështu që ishin jo të besueshme. "Ka një luftë narrativash dhe gjithçka është e lidhur me këtë moment," tha një nga analistët. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti po kritikohet për pranimin e bashkëpunimit me Serbinë, dhe ishte pikërisht ai që ka kundërshtuar çdo lloj bashkëpunimi në të kaluarën. "Kundërshtarët e Kurtit janë duke përdorur rrëfimet e vjetra të Kurtit për ta luftuar tani". Të tjerë thanë se opozita ishte e shqetësuar që dhurimi mund të ketë një efekt në seancën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. "Ministri i Jashtëm serb Ivica Dačić shpërdoroi dhurimin në seancën e Këshillit të Sigurimit dhe poshtëroi Kosovën."

Një analist nga Serbia theksoi se ky është një shembull i bashkëpunimit të mirë, por që është marrë një kundër-efekt politik. Ai theksoi se biseda midis dy ministrave të shëndetësisë në takimin e organizuar me ndërmjetësimin italian ishte më shumë se produktive dhe plot rrespekt të ndërsjellë. Ministrat diskutuan gjithashtu për rritjen e bashkëpunimit në të ardhmen. "Sidoqoftë, atëherë ministrat e jashtëm ndërhyjnë dhe e gjithë historia rrëshqiti në drejtim të politikës së përditshme." Një folës tha që kjo tregoi se profesionistët, ministrat e shëndetësisë, bashkëpunojnë më mirë sesa politikanët, si ministrat e jashtëm.

Shumë e vlerësuan bashkëpunimin pa marrë parasysh sa i vogël ishte dhe sa e kundërshton publiku. Një analist nga Kosova theksoi se ky bashkëpunim përfaqëson "një cilësi të re për të dy palët" dhe se në të ardhmen mund të nënkuptojë vendosjen e një mekanizmi të ri për menaxhimin e krizave. Analisti tha që Kosova bëri më shumë lëshime në këtë bashkëpunim, duke argumentuar se pranimi i testeve ishte dicka mjaft e ndjeshme. "Ishte një hap i vogël për Beogradin, por një hap i madh për Prishtinën." Sidoqoftë, Prishtina fitoi shumë nga ky bashkëpunim pasi veriu, i inkurajuar nga Beogradi, ndoqi masat e qeverisë së Kosovës. Serbia nuk ndërmori asnjë hap për të minuar autoritetin e Kosovës në veri gjatë pandemisë. Rezultati më domethënës është krijimi i bazës së të dhënave të sakta të të infektuarve dhe të vdekurve në veri, pasi përpara marrëveshjes nuk kishte një mekanizëm të tillë kontrolli.

Shumë folës sugjeruan përdorimin e periudhës ekzistuese të përkohshme dhe fillimin e bashkëpunimit midis ekspertëve. Shtë e rëndësishme që bashkëpunimi të mbështetet në publik, por problemi është se me gjendjen aktuale të mediave si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, mund të mos jetë e mundur.

Në Prishtinë situata është shumë e polarizuar, argumentuan disa analistë. Secila palë ka tendencë të përfitojë nga gabimet e tjetrit, duke parandaluar kështu një qasje konstruktive ndaj dialogut. Ndërsa disa pretenduan se Albin Kurti tregoi se ishte i interesuar të ruajë pushtetin dhe se dëshiron të instrumentalizonte situatën rreth dialogut dhe të bëhej "Thaçi i ri në vend të [Presidentit të Kosovës Hashim] Thaçit", të tjerët deklaruan se Kurti tregoi se një politikë dhe qasje e ndryshme janë akoma të mundshme. Disa theksuan se e panjohura kryesore e skenës politike në Kosovë është Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe që nga viti 2007 e deri më sot ata ishin ata që mundësuan "elitën e luftës" të ishte në pushtet dhe të kapte shtetin. Ata theksuan se nëse formohet një qeveri e re, LDK dhe partnerët e tyre të koalicionit do të pajtoheshin për çdo marrëveshje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë që është vendosur në tryezë nga Shtëpia e Bardhë.

Disa thanë që Kurti veproi mirë në çështjet që lidhen me bashkëpunimin me Serbinë dhe nuk iu nënshtrua diskurseve nacionaliste. Një gjë tjetër e mirë është fakti që votuesit e rinj, të cilët

mbështesin Lëvizjen Vetëvendosje, tani po e ndjekin kryesisht Kurtin për shkak të ndryshimit që premtion, jo për shkak të pozicioneve të tij dikur nacionaliste. Të tjerët nuk ishin të bindur, duke theksuar se Kurti humbi momentin politik dhe nuk e njohu ndikimin dhe forcën e faktorëve të jashtëm, veçanërisht të Shteteve të Bashkuara. Një analist nga Kosova e krahasoi atë me ish Ministrin Grek të Financave Janis Varoufakis, i cili u përlesh hapur me Gjermaninë dhe humbi ndikimin e tij politik.

Përfundimet

Një listë përfundimesh mund të nxirren nga diskutimi:

- Pavarësisht nga situata problematike dhe tensionet në komunikimin ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, bashkëpunimi për çështjet e lidhura me pandeminë vazhdon. Kriza dhe bashkëpunimi pasues treguan se oficerët ndërlihdës nuk kanë dëshmuar se i përkasin sfidës dhe mekanizmat alternative duhet të merren parasysh në të ardhmen.
- Për çështje me interes të përgjithshëm, dhe kur bashkëpunimi është i nevojshëm, çështjet e sovranitetit duhet të jenë më pak të rëndësishme dhe fokusi duhet të jetë në atë se si t'u sigurohet të gjithë qytetarëve siguri dhe një kujdes efektiv shëndetësor.
- Marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës janë aq të këqija për momentin, sa ka shumë mundësi për bashkëpunim midis individëve dhe grupeve më të vogla, dhe mbase tani është koha për të forcuar bashkëpunimin midis shoqërive civile.
- Iniciativat e bashkëpunimit, të cilat mund të bazohen në bashkëpunim gjatë një pandemie, varen nga ndikimi i politikanëve si nga qeveria, ashtu edhe nga opozita. Bashkëpunimi duhet të vendoset në disa nivele dhe partnerët e huaj që mbështesin bashkëpunimin duhet të përfshihen gjithashtu.
- Publiku duhet të bëjë presion ndaj politikanëve për të vendosur bashkëpunim për çështje jetike (të identifikuar më parë brenda shkëmbimit të ekspertëve të organizuar nga CIG), si për Serbinë ashtu edhe për Kosovën. Një listë e tillë duhet të përfshihet në një marrëveshje të ardhshme. Nëse bashkëpunimi në luftën kundër COVID-19 është i mundur, pse nuk ka bashkëpunim edhe për çështjet e mbrojtjes së mjedisit, energjisë, etj? BE-ja duhet të ndihmojë një iniciativë të tillë, pasi do të krijojë një realitet të ri në terren dhe në marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës.
- Nuk do të ketë përparim në dialog deri në vjeshtë, kryesisht për shkak të zgjedhjeve në Serbi dhe situatës politike në Kosovë. Çdo iniciativë bashkëpunimi duhet të përqendrohet në atë periudhë, ndërsa kapacitetet për të mbështetur BE në përpjekjet e saj forcohen.

Pjesëmarrësit

Gordana Comic
Shpetim Gashi
Ismet Hajdari
Una Hajdari
Vincent Hug
Sonja Licht
Agon Maliqi
Milivoje Mihajlovic
Branislav Nesovic
Igor Novakovic
Zoran Ostojic
Lulzim Peci
Natasa Petrovic
Jovana Radosavljevic
Alex Roinishvili Grigorev
Nexhmedin Spahiu
Stefan Surlic